



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi


KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Korrik, 2017

Pushuesit shkruajnë përshtypjet e tyre nga pushimi në Durrës Të gjithë shprehen se duhet vazhduar me këtë traditë të mirë



Tradita e mirë e SBASHK-ut për dërgimin e anëtarëve të saj në bregdetin shqiptar edhe këtë vit mori lëvdata dhe respekt nga pushuesit.

Në javën e fundit të qershorit pushimet i filluam me 348 anëtarë, kurse me 72 të tjerë pushimi vazhdoi në javën e parë të korrikut.

Komisioni për organizimin dhe shoqërimin e pushuesve, në përbërje nga kryetari i komisionit Ymer Ymeri i ndihmuar nga Afërdita Ahmeti... (faqe 6)

SBASHK-u bën përgatitje serioze për Kongresin VII

Mijëra anëtarë do të ndihmojnë në plotësim-ndryshimet e Statutit



Me qëllim që të kemi një Kongres plotësisht të suksesshëm, SBASHK-u ka nisur me kohë përgatitjet ... (faqe 7)

Qeveritarët nuk kanë bërë asgjë për mësimdhënësit e sëmurë rënd

Disa për poenë politik e disa për të fituar edhe ndonjë project nga ndërkombëtarët, gjenden në arsim e kanë ... (faqe 8)

Flasin për ju anëtarët e komisionit për mirëvajtjen e pushimeve për anëtarët e SBASHK-ut

Ishte kënaqësi të jesh pjesë e këtij komisioni

- Bajram Shala*
- Avdullah Bujupi*
- Emine Rashiti*
- Feriz Jashari*
- Avdullah Krasniqi*
- Nasibe Kermeni*
- Xhevahire Haxhiu*
- Mamudije Rudi* .(faqe 3-5)

Ta punojmë bashkë gazetën tonë “Arsimimi sot”

Gazetë elektronike që kujton ngjarjet gjatë një muaji



Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut kudo jeni në Planin Strategjik të SBASHK-ut për vitet 2015-2019 ” ... (faqe 8)



Editorial

Në SBASHK jo për interes personal, po për interesin e përgjithshëm



Në ditët më të vështira për arsimin shqip të Kosovës të punësuarit e asaj kohe në këtë sektor me rëndësi u unifikuan në një organizim të mirëfilltë sindikal dhe duke bashkuar akronimet u prezantuan kudo denjësisht me emërtimin SBASHK. Të bashkuar e unik ata përballuan sfidat e kohës dhe furtunat e vazhdueshme të pushtesit kundër arsimit e kulturës sonë. Kjo arritje sepse njerëzit në SBASHK ishin organizuar, jo për interesin personal, po për interesin e përgjithshëm të kombit dhe atdheut. Për interesin e përbashkët të punësuarit në arsim vazhduan aktivitetin në SBASHK edhe në ditët e para të lirisë duke bërë gjithë ato angazhime në shërbim të arsimit e Kosovës. SBASHK-u dha kontribut të lartë në rinisjen e mbarë të procesit arsimor duke mobilizuar anëtarësinë e duke dhënë kontribut të çmuar në renovimin e madje edhe në ngritjen e ndërtesave të reja shkollore. Falë miqve ndërkombëtarë, që më SBASHK-un ishin edhe në ditët më

të vështira, u ndihmuan shumë vatra arsimore me mjete mësimore e u ndihmuan edhe të gjithë të punësuarit në arsim në ditët e para të lirisë. SBASHK-u nuk harroi as familjet e kolegëve tanë të vratë, të cilat i ndihmoi në mënyrë modeste, por shumë domethënëse.

SBASHK-u sot është sindikata më e respektuar në Kosovë dhe ka unitet të shkëlqyer e arritje të mëdha. Edhe sot e gjithë ditën në SBASHK duhet të jemi në emër të interesit të përgjithshëm e jo të atij personal. Duke u angazhuar për interesat e përgjithshme jemi edhe më të fortë dhe ndikojmë në realizimin e kërkesave të mëdha e legjitime dhe ndihmojmë edhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsim.

Ata pak të punuar në arsim që ende mendojnë vetëm për veti dhe sot për sot duhet ta ndryshojnë qasjen dhe të jenë me në SBASHK në mënyrë që të mendojmë e veprojmë bashkërisht për interesat e përgjithshëm të arsimit të Kosovës dhe të të punësuarve në këtë sektor me rëndësi. Prandaj ejani të gjithë bashkë e në SBASHK.

□

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org


Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Flasin për ju anëtarët e komisionit për mirëvajtjen e pushimeve për anëtarët e SBASHK-ut

Ishte kënaqësi të jesh pjesë e këtij komisioni



Bajram Shala

Unë jam Bajram Shala, isha udhëheqës për anëtarët nga rajoni i Mitrovicës. Së pari mund të them se është kënaqësi e krenari të jesh pjesë e SBASHK-ut dhe të angazhohesh në shërbim të anëtarësisë.

Falënderoj SBASHK-un që më besoj të jem në këtë komision, ku

me të vërtet kaluam për mrekulli. Ishte kënaqësi për mua dhe privilegj që të kontribuoj për anëtarësinë e SBASHK-ut. Edhe pushuesit nga rajoni i Mitrovicës janë ndarë shumë të kënaqur me gjithë shërbimet e ofruara si nga ana e SBASHK-ut, po ashtu edhe me shërbimet e hotelit.



Avdullah Bujupi

Quhem Avdullah Bujupi, udhëheqës për rajonin e Pejës.

Të përshkruash punën dhe angazhimin e SBASHK-ut me pak fjalë është pothuajse e pamundur.

Thjesht kisha kënaqësinë që SBASHK-u më besoj të jem në komisionin për mirëvajtjen e

pushimeve për kolegët tanë. Me gjithë forcat jam përkushtuar që cdo detaj të shkojë sipas agjendës së përgatitur nga SBASHK-u dhe më të vërtetë ia dolëm. Ishte për mrekulli çdo detaj i paraqitur.

Edhe pushuesit nga rajoni i Pejës ishin tejet të kënaqur me pushimin në përgjithësi.

Emine Rashiti

Jam Emine Rashiti, vi nga komuna e Kamenicës. Ishte privilegj dhe nderë për mua të jem pjesë e një komisioni me shumë përgjegjësi por edhe kënaqësi. Unë në këtë komision isha udhëheqëse për rajonin e Gjilanit.

Me të vërtet çdo gjë ka qenë e detajuar, duke u nisur nga agjenda e udhëtimit, akomodimit në autobusë, arritjes, akomodimit në dhoma dhe çadra plazhi, agjenda e ushqimit, kontakti i vazhdueshëm me

komisionin qendror, të cilët ishin çdoherë me ne dhe ishin të gatshëm për çdo kërkesë që anëtarët tanë kishin. Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ishte në çdo moment prezent, duke dhënë kontributin e tij maksimal për çdo pyetje që shtronin anëtarët- pushuesit, në takimet që zhvillonim aty për aty.

Është mirë kur je në mesin e kolegëve dhe stafit të SBASHK-ut aq modest dhe përkrahës.



Feriz Jashari

Quhem Feriz Jashari. Ishte kënaqësi të jesh në mesin e shumë

punonjësve arsimor, nga gjitha komunat e Kosovës.

Falënderoj SBASHK-un për besimin që të jem edhe unë pjesë e komisionit për pushuesit-anëtarë të SBASHK-ut. Isha udhëheqës për një pjesë nga rajoni i Prishtinës. Të gjithë pushuesit nga ky rajon u ndanë tejet të kënaqur me organizimin e SBASHK-ut për këtë pushim.

Ata thanë se ky pushim ishte një qershi mbi torte, pasi që përfundam mësimin dhe kishim nevojë për një pushim të llojit të tillë.

SBASHK-u ishte në nivelin e duhur me të gjitha detajet e menduara paraprakisht. Kryetari i SBASHK-ut po ashtu ishte në mesin tonë çdoherë, çdo moment, ku nuk mungonin as takimet e shumta me të, për çështje të ndryshme rreth arsimit.

Edhe një herë falënderoj shumë SBASHK-un për këtë mundësi që më dha.



Avdullah Krasniqi

Puna ime ne SBASHK është një kënaqësi dhe e vlerësoj lartë angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut karshi anëtarësisë.

Falënderoj shumë SBASHK-un që më besoj këtë pozitë.

Të gjithë pushuesit nga komunat që unë isha përgjegjës për ta ishin shumë të kënaqur me organizimin e SBASHK-ut, ku nuk munguan as lëvdatat e tyre, të cilat i shprehen me shumë kënaqësi në fletoren e përshtypjeve gjatë këtij pushimi në Durrës.



Nasibe Kermeni

Jam Nasibe Kermeni. Ishte nderë për mua që SBASHK-u më besoj punën si udhëheqëse për mirëvajtjen e pushimeve për kolegët tanë nga rajoni i Prizrenit.

Ne autobusi ynë, mund të them se ishim pak më me fat, ngase gjendemi më afër Shqipërisë, nuk kishim pse të zgjohemi shumë herët sikurse komunat tjera, pak shaka sa për fillim.

Organizimi i detajuar që nga nisja, vendosja në autobusë, shpërndarja e agjendave dhe orarit të ushqimit e numrit të çadrave për secilin pushues, ishte një dëshmi se SBASHK-u me të vërtet i ka menduar të gjitha.

Me të vërtet ka qenë një përvojë e mirë edhe për mua edhe për të gjithë besoj. Kemi mësuar shumë nga ky organizim i mrekullueshëm i SBASHK-ut, duke përfshirë edhe stafin qendror, të kryesuar nga kryetari z.Jasharaj, të cilët ishin të gatshëm çdoherë për çdo gjë.



Xhevahire Haxhiu

Quhem Xhevahire Haxhiu, vij nga komuna e Vushtrrisë. Për mua ishte një nderë i veçantë të jem pjesë e komisionit të SBASHK-ut për mirëvajtjen e pushimit të kolegëve tanë në Durrës, për çka e falënderoj shumë SBASHK-un për këtë mundësi.

Edhe pse ishte një përgjegjësi të jesh udhëheqëse e një autobusi, njëkohësisht ishte edhe kënaqësi dhe përvojë

e mirë. Unë isha udhëheqëse për një pjesë të rajonit të Prishtinës dhe për Vushtrri.

Përshtypjet që pushuesit nga këto komuna i kanë shkruar në fletoren e përshtypjeve, i kam lexuar një nga një. Ishte me të vërtet mirë të lexosh fjalë aq të mira e të thurura aq bukur, të gjitha ishin lëvdatë pas lëvdate për organizimin e mahnitshëm të SBASHK-ut.

Jo vetëm pushuesit që u ndien mirë, por edhe ne udhëheqësit u ndamë shumë të kënaqur me gjithë stafën qendror të SBASHK-ut, në krye me kryetarin z.Rrahman Jasharaj.

Edhe një herë faleminderit SBASHK për këtë mundësi . Le të vazhdoj kjo traditë e mirë edhe në të ardhmen.



Mahmudije Rudi

Jam Mahmudije Rudi, vij nga komuna e Kaçanikut.

Në pushimin e organizuar nga SBASHK-u, kisha nderin dhe kënaqësinë të jem edhe unë pjesë e komisionit për rajonin e Ferizajt.

Që nga dita e parë e deri në ditën e fundit, cdo gjë ka shkuar sipas agjendës, çdo gjë ka shkuar në nivelin e duhur, siç i ka hije një personeli arsimor, e kjo fal

përkushtimit, organizmit e angazhimit të pa lodhshëm të komisionit qendror të SBASHK-ut. Ishte privilegj për ne të gjithë kur shihnim edhe kryetarin Jasharaj në mesin tonë, i cili asnjëherë nuk u lodh nga pyetjet e shumta që ne të gjithë i bënim, thjesht ishte i gatshëm që edhe pyetjeve më të thjeshta ti kushtonte aq shumë vëmendje e t'i përgjigjej me detaje.

Organizim si ky i SBASHK-ut është hera e parë që unë përjetova, por besoj se edhe shumica nga pushuesit e thonë këtë.

SBASHK faleminderit për besimin e dhënë që të jem pjesë e këtij komisioni e shpresoj se kjo traditë e mrekullueshme të vazhdoj edhe në vitet në vijim.

Të nderuar lexues këto deklarime të kolegëve e kolegeve tona i kemi shënuar gjatë bisedave të lira me këta veprimtarë të mirë. Pra, nuk ishte bisedë klasike , po bashkëbisedë e lirë me ta gjatë ditëve kur 420 anëtarë të SBASHK-ut po kënaqeshin buzë detit shqiptar.

Gjatë muajt

Pushuesit shkruajnë përshtypjet e tyre nga pushimi në Durrës

Të gjithë shprehen se duhet vazhduar me këtë traditë të mirë

Tradita e mirë e SBASHK-ut për dërgimin e anëtarëve të saj në bregdetin shqiptar edhe këtë vit mori lëvdata dhe respekt nga pushuesit.

Në javën e fundit të qershorit pushimet i filluam me 348 anëtarë, kurse me 72 të tjerë pushimi vazhdoj në javën e parë të korrikut.

Komisioni për organizimin dhe shoqërimin e pushuesve, në përbërje nga kryetari i komisionit Ymer Ymeri i ndihmuar nga Afërdita Ahmeti, Vlora Rexhepi Berisha, Blendor Shatri dhe anëtarët nga 7 anët e Kosovës Bajram Shala, Avdullah Bujupi, Emine Rashiti, Feriz Jashari, Avdullah Krasniqi, Nasibe Kermeni, Xhevahire Haxhiu dhe Mamudije Rudi ishin të gatshëm dhe në kohë cdo herë për pushuesit. Me ta ishte gjatë gjithë kohës edhe kryetari

i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili realizoi takime me pushuesit lidhur me shumë çështje me interes për pushuesit.

Vërtet ishte një atmosferë e bukur, të cilën më së miri e tregojnë fjalët dhe përshtypjet e disa nga pushuesve.

Në mesin e 70 përshtypjeve, kemi veçuar disa nga ato, të shkruara me shumë sinqeritet nga anëtarët tanë, pushues në bregdetin shqiptar : Sulltanie Xhoshja nga komuna e Vushtrrisë, Ismet Azemi nga Teatri Kombëtar, Xhafer Avdyli nga komuna e Pejës, Daut Shehu nga komuna e Kacanikut, Rexhep Bllaca nga komuna e Prizrenit, Ylber Krasniqi, Ragip Behluli e Sami Jashari nga komuna e Lipjanit dhe Nazan Kërveshi nga Zveçani.

29.VI.2017
Kushtet e sanimit ishin të mira.
Shtrësit e dhomave të rehatshme,
sikur edhe ata në plazh.
Udhëtimi i këmbësorëve, uletor
ollë me bollëk.
Shërbimi tepër i mirë.
Nënvizoj organizimi i kësaj
pushimi nga simpatistat mend
të instatet me stafin me
të lartë: njëja me lartë,
udhëtimi i rehatshëm, venologji
nëpër dhoma dhe shërbime
e shërbime në plazh ishin
për çdo lëndë.
Përshtypjet e shpejtë:
Daut Shehu, Profador
në Gjykatën e Skenderbeut
në Kacanik

Mirënjohja 30.6.2017
SBASHKUT
Fillimi që nga nisja e ditës të
arritja, për mua ishte shumë e pyetur
vetëm gjatë, kur po shkoj, por që shkoj,
qpa ditë të tjera, kështu ditëve të mëjta.
Por gjithëcka ndryshoi, sepse kështu
me një ditë - dhe faktin që prisat
simpatistat si Bajrami, Ragip, jllca,
një jllca dhe komiteti për jetë të
përmirësimit të njerëzve dhe
Sotë të doja me siguri ma tani
Respekt SBASHKUT
Për këtë organizim të nivelit
kërkohet. Udhëkëmbësorët
falemnderim të kujdesit
që kishit për ne të gjithë
Mëndel ju Uniq.
Daut Shehu
Ismet Azem
Teatri Kombëtar

16.06.2017
Përshtypjet tona të dedikuara pushimeve të
organizuar nga SBASHK-u në bregdetin
shqiptar - Shërbimi i lartë.
Organizimi që nga dita e parë ishte
organizuar në nivelin e duhur. Shërbimi edhe
udhëtimi dhe rëndësia kanë shquar sipas
dijencës së planifikuar. Qjeto kohë të
qëndrimit në bregdetin shqiptar sistemim,
ushqimi dhe përvojat nga stafi i SBASHK-ut
e shquar nga Anjeksi z. Rrahman Jashari,
Ymer Jmer dhe Avdullah Krasniqi kanë qerë
në nivelin e duhur. (Një organizim të tillë
punëtorët e arsimin e kanë merituar shumë në heret
por që në këtë realitetin. Kjo formë e organizimit
të pushimeve për punëtorët e arsimin propozojmë
që të rrezhohet edhe në të ardhmen.
Udhëkëmbësorët
Ylber Krasniqi, Ragip Behluli dhe
Sami Jashari
Gjilim Shqipon

30.6.2017
Me lepton që nga zëmba të përkrahës
kërkohet i SBASHK-ut shërbime dhe
qjeto stafi të cilët bëjnë bregdetin të
madhe për të gjithë ne. Falemnderim shumë
leptonit ditë e caktuar për ne. Kështu
të rrezhohet dhe në mbledhjen me mbledhjen
dhe komiteti gjatë të cilët ditët e
i kam vlerë për tanë nga ditët të
nivelet për mua dhe për bashkëtimin
shërbime dhe përvoja të cilët ditët të
jesin në mbledhjen e mirë.
SAMI JASHARI
Ismet Azem
Teatri Kombëtar
Nazan Kërveshi

P. të Kosovës Z: Rrahman Jasharaj
si dhe gjithë grupin udhëheqës të
komunës së Prizrenit. Falemnderojmë
edhe udhëheqesin e Nasibe Kermeni.
Durrës 2017
1. Pëllumbi
2. Pëllumbi
3. Pëllumbi
4. Pëllumbi
5. Pëllumbi

Datë: 30.06.2017
Nga: Rexhep Bllaca - përfundues i
SHFPU "Brohimi Fehmiu" Prizren
Koment - për këtë pushim
në ditë - Durrës prej datës: 26.06.2017
deri me datë: 01.07.2017, organizuar
nga SBASHK-u.
Në punëtorët e arsimin në nivelin të
nga komuna e Prizrenit ju falemnderojmë
për këtë qerë human dhe jemi dakorduar
që kjo të rrezhohet edhe në të ardhmen. Kështu
edhe rrezhohet dhe në nivelin të
Ditën e parë të udhëkëmbësorit jemi të kërkim
me organizimin që ishte në nivel të
shkëlqyeshëm, si në nivelin dhe sistemimin
të nëpër dhoma, rehatim e shërbime dhe
arimim e të udhëkëmbësorit që ishte në nivel
të shkëlqyeshëm. Falemnderojmë edhe
kryetarin e SBASHK-ut për nivelin të

29.06.2017
 Sullbime Shkencë SHAP Niveli
 "BANI HANA"

Duke ju falenderuar Shikuarin për detyrat që na jepni në të kaluarën e përgjigjeve që na jepni në të kaluarën na u shprehim të kënaqur për detyrat që na jepni në të kaluarën.

Gjate këtyre ditëve gjatë punës në hotelin "BANI HANA" kemi marrë pjesë në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit.

Udhëzimet që na jepni në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit.

në orët e mëngjesit, për t' i bashkuar problemet nga jeta e përditshme.

Do t' u përkrahim që ky organizim të ardhshëm jetë, të t' i shijoj shprehjen bukurinë e këtyre plotë dhe mirënjohjen e vëllezërve shqiptarë.

Mos harroni t' i shijoni këto momente!

04.07.2017

XHAFFER AVDYLI - mesimdhënës (profesor) i shkollës së mesme të ulët "Zef Serembe" Gllavisirë - Pejë

Pashtypjet e mijës për pushimin 5 ditësh të organizuar nga ana e SBASHK-ut me kryedritin Shqipëtarë, Shqipëria dhe Kosovë, Durres me Hotel "Banita".

Me datën 04.07.2017 në Pejë u bë organizimi - tubimi i mesimdhënësve dhe punësorëve të kësaj qyteti për filluar ardhjen në kryedritin Shqipëtarë. Në ora 5 të mëngjesit në stacionin e autobusëve ishim të detyrë dhe keshillat menjëherë u morën nga keshillatort, i pajisur me detyrat. Bujari i cili me shumë keshillatort e bëri këtë organizim.

dhe me ora 5:45 u nisëm me autobus për Durres, gjatë rrugës me siguri gjatë rrugës. Në ora 11:30 ardim në destinacion Durres, dhe menjëherë u drejtëm për të sistemuar në hotelin "Banita" ku mësonim një kohë të shkurtër në sistemin e punës dhe punën e shkollës shkollore.

Udhëzimet që na jepni në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit dhe në punën e organizimit të Kongresit.

Restauranti me kishite kapacitet të plotë për pritje e mysafirëve, Pastërtia mjafte e kishit me nivel. Shërbimet e mira me një staf të moshkulluar dhe i trajnuar. Përmat e gjatës të rrugës për moshkulluar dhe i trajnuar. Përmat e gjatës të rrugës për moshkulluar dhe i trajnuar.

Në i detyrojmë stafit të hotel "Banita" punë të mirë dhe shërbime të mirë.

Ju falënderojmë për mirëpunë.

SBASHK-u bën përgatitje serioze për Kongresin VII

Mijëra anëtarë do të ndihmojnë në plotësim-ndryshimet e Statutit

Me qëllim që të kemi një Kongres plotësisht të suksesshëm, SBASHK-u ka nisur me kohë përgatitjet për këtë ngjarje me rëndësi. Kështu viti 2017 është shpallur vit i zgjedhjeve dhe në të gjitha komunat dhe në Universitet janë në përfundim e sipër zgjedhjet nëpër shoqata sindikale. Këto zgjedhje kanë bërë që të ketë kuadro të reja udhëheqëse në shumë shoqata dhe në takimet zgjedhore është debatuar edhe për arritjet dhe detyrat që duhet bërë. Pas kësaj do të vazhdohet me zgjedhjet në Kuvendet e SAF e SAM dhe Kuvendin e Universitetit dhe të arsimit fillor e atij të mesëm.

Krahas këtij aktiviteti i është kushtuar rëndësi e madhe edhe Statutit, si dokumenti më i rëndësishëm e bazik i veprimtarisë së SBASHK-ut. Kështu Kryesia ka autorizuar Komisionin statutar të nis angazhimet

për plotësim-ndryshimet e Statutit. Kryetari i këtij komisioni Ymer Ymeri ka organizuar takimin e parë të Komisionit të cilin e përbëjnë edhe Bardh Bardhi, përfaqësues i Universiteteve, Besnik Krasniqi, përfaqësues i Arsimit të mesëm, Jehon Oruqi, përfaqësuese e Arsimit fillor. Këtij Komisioni do t' i ndihmojnë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe juristi Blendor Shatri.

Me qëllim që Statuti të jetë sa më i plotë, Komisioni ka marrë vendim të qëlluar që Statutin aktual ta shpërndajë në mijëra adresa elektronike të anëtarëve, në adresat e anëtarëve të Këshillit Drejtues

dhe të Kryesisë me porosinë që ta të japin propozime konkrete për ndryshimet dhe plotësimet që i duhen bërë Statutit, ndryshime këto që do të paraqiten para delegatëve të Kongresit VII për aprovim.

Kryetari i Komisionit statutar Ymer Ymeri shprehet bindur se shumë nga anëtarët e SBASHK-ut

do të japin kontributin e tyre me propozime konkrete për ndryshime pozitive në statutin e SBASHK-ut dhe kështu ky dokument i rëndësishëm së veçantë do të jetë shumë funksional dhe do të ndihmojë në forcimin e SBASHK-ut dhe punën sa më kreative të sindikatës sonë.

Ta punojmë bashkë gazetën tonë “Arsimimi sot” Gazetë elektronike që kujton ngjarjet gjatë një muaji

Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut kudo jeni në Planin Strategjik të SBASHK-ut për vitet 2015-2019 një vend me rëndësi i është dhënë komunikimit dhe



informimit me kohë të anëtarësisë me angazhimet, sfidat dhe aktivitetet e SBASHK në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë së SBASHK-ut. Për këtë arsye kemi ridizajnuar ueb faqen tonë dhe kemi marrë vendim që të bojmë gazetën mujore elektronike “Arsimimi sot”. Në ueb faqe dhe ne rrjetin social të SBASHK-ut në , po thuaj çdo ditë , publikojmë lajme të reja që kanë të bëjnë me aktualitetin dhe me përprjekjet e sfidat e SBASHK. Duke klikuar në të, ju do ta forconi këtë faqe dhe të tjerët, që janë shumë dhe e lexojnë, do të shohin se kemi shumë vizitorë nga anëtarësia jonë.

Të nderuar anëtarë me qëllim që t’ju kujtojmë ngjarjet më të rëndësishme të një muaji e që lidhen me

SBASHK-un dhe rreth SBASHK-ut ne me forca vullnetare gazetareske e redaktuese botojmë çdo muaj gazetën elektronike “Arsimimi sot” me qëllimin që t’ua

rikujtojmë ngjarjet kryesore të rëndësishme e që lidhen me aktivitetet e SBASHK-ut gjatë muajit të caktuar. Këtë gazetë të dizajnuar bukur e me shkrime interesante nisim në mijëra adresa të anëtarëve tanë, që kanë dërguar adresat e tyre te ne , dhe të shumë e shumë adresa të njerëzve të dijes e kulturës kudo në Kosovë.

Ne do të vazhdojmë me këtë traditë të botimit të gazetës së SBASHK-ut, por që ajo të jetë edhe më e lexueshme dhe me komplete presim idetë, komentet dhe shkrimet tuaja, që do të botohen në numrat e radhës. Me dijen dhe forcat e përbashkëta kjo gazetë jona do të jetë edhe me e plotë dhe më e lexueshme.

Presim bashkëpunimin tuaj.

Redaksia e gazetës **Arsimimi Sot**

Qeveritarët nuk kanë bërë asgjë për mësimdhënësit e sëmure rënd

Disa për poenë politik e disa për të fituar edhe ndonjë projekt nga ndërkombëtarët, gjendjen në arsim e kanë paraqitur me ngjyrat më të zeza aq sa një pjesë e prindërve respektin e lartë që kishin ndaj mësuesit të fëmijëve të tyre kanë filluar ta zëvendësojnë me urrejtje. Subjektet politike që ishin në pushtet, qoftë në nivelin lokal a qendror, arsimin e shpallnin prioritetet, por vazhdonin ta përdornin për të larë borxhin ndaj atyre që kishin vrapuar anë e kënd vendit për të siguruar vota duke i qerasur me pozita drejtorësh të shkollave.



Për ta ngritur cilësinë dhe për të qenë të gatshëm mësimdhënësit të ecin në hap me zhvillimet e hovshme teknologjike shteti duhet ta ndërrojë qasjen ndaj arsimit dhe duhet përfillur kërkesa e SBASHK-ut që

punëtorët e arsimit që janë të goditur nga sëmundje të rënda të lirohen nga procesi arsimor dhe t'u jepen pensione dinjitoze. Ata njerëz sot e gjithë ditën shkojnë në shkollë sa për ta ruajtur vendin e punës dhe

ndihen plot siklet që pas dekadave të punës së përkushtuar sëmundja e rënd nuk i lë të japin kontributin e tyre dhe shpesh edhe bëhen objekt talljeje nga një pjesë e nxënësve apo objekt ofendimi nga prindërit.

A mund të flitet për humanizëm të qeveritarëve lokal e qendror kur ata nuk bëjnë asgjë për këta njerëz, që sa ishin shëndosh u munduan me tërë dijen të kontribuojnë për arsimimin dhe edukimin e brezave e tani me hapin e rënduar nga sëmundja shkojnë në shkollë se ndryshe do të mbesin pa bukën e gojës. Nuk janë shumë në numër këta njerëz dhe shteti me pak angazhime do të siguronte mjete e do t'i dërgonte në pushim të merituar duke ua siguruar një pension të dinjitetshëm. Atyre pikërisht tani, kur sëmundja i ka rrënuar, u duhet dora e shtetit. U duhet ndihma që të jetojnë të qetë e të ndjehen mirë sepse dikush po mendon për ta.

Për ta ngritur cilësinë, mbase, duhet edhe të zbritet mosha e pensionimit në mënyrë që mësimdhënësit në moshën 60 vjeçare t'i lënë lamtumirën shkollës dhe të gëzojnë një pension meritore e në vend të tyre të vijë kuadro të reja që në Kosovë ka mjaft dhe janë duke pritur me vite për të gjetur një vend pune.

Gjithë këto çështje i ka ngritur tani e sa kohe SBASHK-u. Qeveritë lokale e ajo qendrore mund të thonë se këto veprime kushtojnë, por ata duhet të kenë qasje të drejtë ndaj arsimit dhe të kuptojnë se sado buxhet i lartë që i dedikohet arsimimit të gjeneratave, ato mjete nuk janë shpenzime kot, po janë investime për të ardhmen e këtij vendi.

Është bërë ironik e bajat deklarimi "Arsimi është prioritet për shtetin. Duhet veprime dhe investime konkrete.